



PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë

1. Bleta dëshiron të arrijë te lulja. Cili kombinim kahesh të lëvizjëve ia mundëson këtë?


- (A) $\rightarrow \downarrow \rightarrow \downarrow \downarrow \rightarrow$ (B) $\downarrow \downarrow \rightarrow \downarrow \downarrow$ (C) $\rightarrow \downarrow \rightarrow \downarrow \rightarrow$
 (D) $\rightarrow \rightarrow \downarrow \downarrow \downarrow$ (E) $\downarrow \rightarrow \rightarrow \downarrow \downarrow \downarrow$



2. Rrezet e lazerit reflektohen në pasqyra siç tregohet në figurë.




Te cila shkronjë do të përfundojë rrezja e lazerit?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


3. Rita dëshiron t'i vendos 2 monedha në çdo rresht dhe në çdo kolonë të rrjetës/tabelës.



Cilën monedhë duhet ta levizë ajo në një hapësirë/qelizë të zbrazët?


- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

4. Sa është numri më i vogël i kutive që duhet t'i levizë Besniku në mënyrë që të mund të hapë kutinë e zezë me mbishkrimin TRAIN?



- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7

5. Kangurit Kengu i pëlqen të kërcëjë në vijën numerike. Ai çdo herë e bën një kërcim të gjatë ndjekur nga dy kërcime të shkurtëra, si në figurë. Kengu fillon kërcimin në numrin 0 dhe e përfundon në numrin 16. Sa është numri i kërcimeve që bën Kengu?



- (A) 4 (B) 7 (C) 8 (D) 9 (E) 12

6. Ana e ndërton një lojë me bashkim pjesësh, ku dy katrorë me brinjë të përbashkëta nuk mbajnë të njëjtin numër.

3	2	5	4	2	1
1	4	3	1	3	4
2	5		5	2	1
4	1				3
3	2	4	2	5	2
4	1	3	1	3	4

Cilën pjesë duhet ta vendos ajo për ta përfunduar lojën?

- (A)

4
1 2 3

 (B)

1
3 4 2

 (C)

2
4 1 3

 (D)

2
3 1 4

 (E)


3
2 1 4

7. Cilët numra mund të vendosen në dy kutitë në mënyrë që barazimi të jetë i saktë?


$$2022 + \square = 2020 + \square$$

- (A) 3 dhe 5 (B) 4 dhe 1 (C) 3 dhe 4 (D) 7 dhe 2 (E) 9 dhe 8

8. Joni e ndërton kullën e treguar në figurë.




Çka do të shikojë ai nëse e shikon kullën e tij nga sipër?



PJESA B: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë

9. Pesë makinat e numëruara me 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë duke lëvizur në të njëjtin kah.



Së pari, makina e fundit (5) i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Pastaj, makina e parafundit i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Në fund, makina në mes i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Në çfarë renditje janë makinat tani?

- (A) 1, 2, 3, 5, 4 (B) 2, 1, 3, 5, 4 (C) 2, 1, 5, 3, 4 (D) 3, 1, 4, 2, 5 (E) 4, 1, 2, 5, 3

10. Moshat e një familje kangurësh janë 2, 4, 5, 6, 8 dhe 10 vjeç.
 Shuma e moshave të katër prej tyre është 22 vjeç.



Sa vjeç janë dy kangurët tjerë?

- (A) 2 dhe 8 (B) 4 dhe 5
 (C) 5 dhe 8 (D) 6 dhe 8
 (E) 6 dhe 10



11. Gjatë pushimeve unë ia dergova pesë kartolinat e shfaqura më poshtë shokëve të mi.

Dihet që në kartolinën e Meritonit **nuk** ka rosa.


Kartolina e Sarës përmban diellin.

Në kartolinën e Poemës janë saktësisht dy gjallesa.

Kartolina e Lyrës ka një qen në të.

Në kartolinën e Hanës ka kangurë.

Cilën kartolinë mori Meritoni?




12. Mali dëshiroi që shuma e tre numrave në secilin rresht dhe në secilën kolonë të rrejtës/tabelës të jetë e barabartë. Ai bëri një gabim. Cilin numër duhet ta përmisojë ai?

9	1	5
3	7	6
4	7	4

- (A) 1 (B) 3 (C) një nga numrat 4
 (D) 5 (E) një nga numrat 7


13. Aladini ka një qilim katror. Përgjatë secilit skaj të qilimit, ka numër të njejtë pikash të vendosura në dy rrede. Fatkeqësisht, qilimi është palosur pjesërisht.



Sa pika ka në qilimin e Aladinit?

- (A) 48 (B) 44 (C) 40 (D) 36 (E) 32

14. Jona e palos katrorin me numra dy herë siç tregohet në figurë. Pastaj ajo hap një vrimë nëpër njollën e zezë të treguar me shigjetë. Nëpër cilët numra hap ajo vrimën?



- (A) 8, 11, 26, 29 (B) 14, 17, 20, 23 (C) 15, 16, 21, 22 (D) 14, 16, 21, 23 (E) 15, 17, 20, 22

15. Nxënësit ulen në një klasë nëpër rreshta.

Çdo rresht ka numër të njejtë nxënësish.


Janë 2 rreshta me nxënës para Rronit dhe një rresht nxënësish pas tij.

Në rreshtin e Rronit, janë 3 nxënës në anën e majtë të tij dhe 5 nxënës në anën e djathtë të tij.

Sa nxënës janë gjithsej në klasë?

- (A) 10 (B) 17 (C) 18 (D) 27 (E) 36

16. Kubi i treguar në figurë është ndërtuar nga tre lloje blloqesh druri. Sa blloqe të bardha druri janë përdorur?



(A) 8

(B) 11

(C) 13


(D) 16

(E) 19

PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

17. Vesa zgjodhi disa nga figurat e mëposhtme dhe tha “Ndër figurat që kam zgjedhur, janë 2 të ngjyrosura, 2 të mëdha dhe 2 të rrumbullakëta”.

Sa është numri më i vogël i figurave që ka mundur t'i zgjedh Vesa?



(A) 2

(B) 3

(C) 4

(D) 5

(E) 6

18. Tri skuadra futbollit marrin pjesë në një turne sporti.

Secila skuadër luan me dy skuadrat tjera saktësisht një herë.

Në çdo lojë, fituesi merr 3 pikë dhe humbësi nuk merr asnjë pikë.

Nëse loja përfundon me barazim, secila skuadër merr 1 pikë.

Në fund të turneut, cila nga mundësitë **nuk** mund të jetë numri i pikëve të ndonjë skuadre?

(A) 1

(B) 2

(C) 4

(D) 5

(E) 6

19. Një piramidë është ndërtuar nga kube me brinjë me gjatësi 10 cm.

Një milingonë u ngjit lart dhe e kaloi piramidën, siç tregohet nga vija e kuqe në figurë.

Sa është gjatësia e rrugës të cilën e ka bërë milingona?


(A) 30 cm

(B) 60 cm


(C) 70 cm

(D) 80 cm



(E) 90 cm



pamja nga lartë



20. Alma dëshiron të vendos një nga pjesët e treguara në mes të figurës në mënyrë që një femijë në A të mund të udhetojë në B dhe në E, por jo në D. Ajo mund t'i rrotullojë pjesët.



Cilat janë dy pjesët që mund t'i përdorë ajo?


- (A) 1 dhe 2 (B) 2 dhe 3 (C) 1 dhe 4 (D) 4 dhe 5 (E) 1 dhe 5

21. Artani and Zana fillojnë të lëvizin nga pika A me të njëjtën shpejtësi, në kahet e treguara në figurë.

Artani ecën përreth kopshtit në formë katrori dhe Zana ecën përreth kopshtit në formë drejtkëndëshi.

Ata takohen përsëri në pikën A.

Sa është numri më i vogël i xhirove përreth kopshtit në formë katrori që duhet t'i bëjë Artani që ta takojë Zanën?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3
(D) 4 (E) 5

22. Pesë fëmijë kishin ngrënë disa kumbulla.

Leona kishte ngrënë dy kumbulla më shumë se Sara.

Bardha kishte ngrënë tri kumbulla më pak se Leona.

Kaona kishte ngrënë një kumbull më shumë se Bardha dhe tri kumbulla më pak se Artta.

Cilat vajza kishin ngrënë numër të njëjtë kumbullash?

- (A) Kaona dhe Leona. (B) Kaona dhe Sara. (C) Leona dhe Artta.
(D) Sara dhe Artta. (E) Artta dhe Bardha.

23. Shushunja e vogël e treguar në figurë rrudhet që të fle.



Cila nga mundësitë e mëposhtme mund të jetë pozita e rrudhur e shushunjës?

- (A) (B) (C) (D) (E)

24. Në rrjetën/tabelën e treguar, i njëjti numër është fshehur nën katrorët me ngjyrë të njëjtë.

Në anën e djathtë të secilit rresht, është paraqitur shuma e tri numrave të fshehur nën katrorët e rreshtit përkatës.

Cili numër është fshehur nën katrorin me ngjyrë të zezë?

(A) 6

(B) 8

(C) 10

(D) 12

(E) 14

			→ 34
			→ 32
			→ 26